



KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

DECANI

Mbledhja e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII , mbledhja e II) me dt.28.03.2025



DEÇAN

e Premte, 28 Mars 2025

Hajdar Sutaj

Kolegë e hapi mbledhjen e 2-të të rregullt të kuvendit të komunës për vitin 2025, fillimisht konstatoj që nga 27 anëtarët të kuvendin komunal 23 janë prezent prej tyre 4 mungojnë me arsye por gjithsesi ka kurum të mjaftueshëm me vazhdu me punimet e seancës së kuvendit ashtu siq e keni marr edhe materialin për rend dite propozoj këtë rend pune, 1 shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit nga mbledhja e kaluar, 2 caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit për banim social, 3 është shqyrtimi i kërkesës së këshillit të Bashkisë Islame në Deqan për ndarjen e një hapësirë për ndërtimin e objektit të këshillit të bashkisë Islame në Deqan 4 është shqyrtimi i kërkesës së komunitetit të fshatit Lluka e epërme për ndarjen e një hapësirë për ndërtimin e objektit për nevojat e komunitetit të fshatit Lluka e Epërme, pastaj me rekomandimin e komitetit për politikë e financa e kemi po ashtu me e futë si pikë dite kërkesën e kryetarit për shpalljen e pronës me interes publik për iniciimin e procedurës së shpronësimit të të njëjtës pronë, parcellë katastrale 00094-0 zona kadastrale në Lobush, pastaj me propozimin e kryetarit ashtu si e ka pas një takim edhe me përfaqësuesit e subjekteve politike sot është edhe marrja e vendimit për shpalljen qytetar nderi të gjeneral brigade dhe Artur Garfield. Te të ndryshmet po ashtu propozoi që ta kemi një plotësim ndryshim të vendimit në të cilën e kemi pasur aprovimin e listës rezervë me emra të rrugëve të aprovuar sipas fshatrav në komunën e Deçanit, të cilën e kemi miratuar me datën 27.02.2025, nëse ka dikush tjetër diçka në lidhje me rendin e ditës te të ndryshmet, po zotri Mon Selmanaj.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, kryetarin dhe gjithëpranishëm, unë për rendin e dites e kam një vrejthe rreth transkriptës dhe mendoj që ne nuk.. e kemi munges si material dhe prandaj duhet të hiqet nga rendi i ditës shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit dhe i njëjti të vijë në seancën e radhës, 2 kërkoj një njoftim për.. ne muajin e kaluar e kemi miratuar planin e punës së kuvendit dhe për këtë muaj parashihet që të shqyrtohen pikat, shqyrtimi i miratimit draft statutit të Qkmf-së dhe marrja e vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti paraprak 2024 në vitin aktual 2025 këto 2 tema nuk janë përfshir në këtë rend pune, ndërsa në të ndryshmem e kam një qështje për drejtorin e administratës për të cilin kisha kërkuar një njoftim për gjendjen e objektit të komunës dhe të oborrit, kur e them këtë ndoshta e elaboroj ose e paraqes opinionin tim për këto 2 qështje nëse aprovohet kjo pikë ose ky njoftim në pikën te të ndryshmet ju faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit zotri Mon, dikush tjetër Yllarta Thaqi.

Yllarta Thaqi

Faleminderit përshëndetje për të gjithë, në seancën e kaluar kemi bërë disa pyetje sa i përket drejtorisë për kulturë rini dhe sport edhe disa sqarime kam kërkuar nga drejtoresha për kulturë, rini dhe sport e shoh se sot nuk është prezent kisha dashur që të marrë informacione se a kan shku ato pyetje parlamentare te drejtoresha për me ardhë sot për këtë seancë apo ka mbetur vetëm si transkriptë ose të shënuara dikund faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Yllarta, dikush tjetër Vatan Istrefaj.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues, përshëndetje për të gjithë, po ashtu edhe në teknikat e ndryshme kanë 1 kërkesë për kryetarin apo për drejtorin e shërbimeve publike, të cilën kërkes ja kam përcjellur edhe në mënyrë fizike drejtorit të shërbimeve publike po ashtu disa pyetje për kryetarin e komunës faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë atëher po përgjigjem kështu e para sa i përket qështjes të cilën e ngriti kolegu jonë zotri Mon Selmanaj, po transkripti mungon në këtë mbledhje për shkaqe teknike nuk ka arrit me u pregadit edhe si i

tillë e propozojm me largu për mbledhjen e arshme, për sa i përket statutit të Qkmf-së, nuk ka qenë i gatshëm, prandaj ka mbetur të shqyrtohet në mbledhjen e muajit të ardhshëm sa i përket shqyrtimit të pikës që ka qenë në plan të punës për bartjen e të hyrave ka mundësi ndoshta edhe drejtoresha me na jep një sqarim meqenëse është këtu prezent dhe më kompetente, drejtoresha a dëshiron me marr fjalën me na tregu pak sa i përket po e kisha kalu fjalën të drejtoresha për buxhet dhe financa e pastaj po i përgjigjem edhe pyetjeve të kolegëve të tjerë.

Dafina Cacaj

Mirënjohës për të gjithë, të hyrat e të barturave sipas planifikimit që kan qen, nuk kemi mundur me i sjell në asamble për arsye se nuk jan barazuar ministria e departamentit ndërmjet veti pas pranimit të pasqyrave financiare, kjo edhe ka qen përgjigja e tyre edhe pse me ligjin për buxhet tash vetëm nëse ka tejkalim të të hyrave vjen në asamble vendimi na këtë vit kemi pasur por nuk kam mundur me sjell pa u barazuar ata që me e ditë sakt si e kemi situatën besoj në muajin tjetër vijn.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, tema të tjera të cilat i ngritët sigurisht do ti diskutojm tek të ndryshmet domethanë do ta kemi parasyshë edhe pyetjet e zotri Monit, Yllartës, Vatanit dhe tek të ndryshmet i diskutojm, e qes në miratim rendin e ditës duke e pasur parasysh 3 pika që i propozuam për tu shtuar dhe pika e parë që e propozuam per mu largu, kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që kuvendi në mënyrë unanime ka miratuar rendin e ditës dhe jemi të gatshëm me vazhdu, tashmë pikën e parë që është caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit për banim social, materialin veç e keni pasur, e kisha kalu fjalën të shefat e grupeve ose përfaqësuesit e subjekteve politike fillimisht e pastaj te anëtarët tjerë dhe varësisht nga pyetjet i kemi këtu edhe kryetarin e komunës dhe zotri Bashkim Ramosaj dhe drejtorin e urbanizmit zotri Ramë Melaj dhe tjerët që munden me japë shpjegime, në emër të grupit të Aak-së Arian Dobraj.

Arian Dobraj

Faleminderit kryesus Hajdar Sutaj, i nderuar kryetar Ramosaj, të nderuar kolegë dhe drejtorë nga egzekutivi, kërkesa për ndarjen e parcelës për ndërtimin e njërive të reja banesore, që janë edhe për banim të përballeshëm duke nisur nga vetë tematika e kësaj kërkesë dhe duke u bazuar në kërkesat e bëra nga vetë qytetarët në nevojë, pra për të pasur 1 strehë dhe natyrisht për nga pamundësia e tyre për të siguruar 1 gjë të tillë, grup i asambleistëve të Aak-së në kuvendin komunal e mbështet kërkesën e kryetarit Ramosaj dhe e përgëzon për idenë e realizimit të këtij projekti të një rëndësie shumë të veçantë, urojmë që së shpejti të fillojnë procedurat dhe të nisë ndërtimin e njërive të parapara sipas projektit në fjalë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit zotri Dobraj, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës shefja e grupit, përfaqësuesi i këtij subjekti zotri Vatan Istrefaj.

Vatan Istrefaj

Faleminderit kryesues atëherë sa i përket kësaj pike, nëse e marrim dhe e shohim memorandumin e komunës së Deqanit që ka lidhur Ministrin e Infrastrukturës me ministrin Liburn Aliu e shohim që memorandumit është vetëm për ndërtimin e njërive banesore për banim social e jo për banimin e përballeshëm, atëher kryetar si e keni parë realizimin dhe financimin e këtij projekti pra për banimin e përballeshëm e kam fjalën pasi që nuk është pjesë e memorandumit faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë nga lëvizja Vetëvendosje, Teuta Neziraj.

Teuta Neziraj

Atëher përshëndetje për të gjithë, ky projekt banimi social domethanë ka qenë 1 nga zotimet e qeverisë së Republikës së Kosovës dhe shprehja e interesit nga komuna e Deqanit për këtë projekt është 1 hap i duhur dhe në të mirë të qytetarëve, specifikisht atyre të cilët kanë mungesë të ardhurave dhe problemet e banimit, duke përfshirë sidomos personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe prindërit vetëushqyes, për këtë arsye ne e japim pajtimin për ndarjen e hapësirës apo parcelën për projektin e banimit të përballeshëm.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Teuta, zotri Mon Selmanaj.

Mon Selmanaj

Unë e mbështes dhe e shoh të nevojshëm këtë projekt prandaj e mbështes në tërësi.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, në lidhje me pyetjen që e pati përfaqësuesi i Ldk-së Vatan Istrefaj për pjesën tjetër të planit për banim social zotri Ramë Melaj e ka fjalën, drejtori i urbanizmit.

Ramë Melaj

Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesus, përshëndetje për të gjithë, banimi i përballeshëm është një program qeveritar i cili i është siguruar fondi nga fondet e qeverive të Bashkësisë Evropiane, ku ai fond do të implementohet në tërë teritorin e Kosovës, ky banim ka të bëjë për qiftet e reja të cilët nuk kanë mundësi banimi domethanë për tu vendosur në ndonjë objekt tjetër e këto objekte të cilat do të ndërtohen janë për këtë qëllim ata do të paguajn gjatë kohës së banimit qdo muaj një shumë solide kështu që pas përfundimit të shumës e cila kushton ai banim do të mbetet i tyre domethan fondi është i qeveris të cilin e menaxhon Ministria e Ambientit Planifikimit Hapsinor komuna nuk ka të bëjë këtu me investu por nga niveli qendror.

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtor, e hapi debatin për anëtarët e kuvendit nëse ka dikush diçka për të thënë, nëse nuk ka e qes në votim

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoh që kuvendi në mënyrë unanime e ka miratuar caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për banim social, jemi te pika e 2-të shqyrtimi i kërkesës së këshillit të bashkësisë islame në Deqan për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e objektit të këtij këshilli në Deqan, fillimisht në emër të grupit të Aak-së zotri Arian Dobraj.

Arjan Dobraj

Faleminderit edhe njëherë kryesus, kërkesa e bashkësisë islame në Deqan për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e objektit zyrtar të tyre, ku ata do të zhvillojnë takime ose edhe pritje e musafirëve të ndryshëm për arsye të shumta është një ide e mir dhe natyrisht që një kërkes e mir duhet të aprovohet patjetër, realisht ne e dim se në Deqan domethanë është një pjesë shumice e fesë Islame pa dashur me ndiku diçka se Deqani njihet realisht për tolerancën fetare që e ka nivelin më të lart të mundshëm e përgëzojm edhe kryetarin Kbi-së në Deqan, të Këshillimit të Bashkësisë Islame në Deqan zotri Naser Tolaj dhe i urojm suksese në detyren e re që e ka marr pak para disa muajve faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit zotri Dobraj, në emër të Ldk-së? Hyrije Dobrunaj.

Hyrije Dobrunaj

Gjithashtu edhe Ldk-ja pajtohet me këtë vendim, nuk është ende vendim mirëpo ne si Ldk gjithmonë i kemi ato kërkesat tona, ndoshta është dashur me ardhë me një plan paraparak të ndërtimit edhe me një mbështetje financiare nga ku e marrin me investu unë nuk po e kuptoj këtu në bazë të kësaj ku është aj lokacion mirpo unë besoj që keni me rrespektu edhe rregullat që ato duhet me kanë pak larg shkolla pak në vend të caktuar, nuk kemi kurgjo kundër as të një objekti fetar qoftë aj Msuliman ose Krishter ose.. e mbështesim vetëm se mendojmë që materiali është i mangët.

Hajdar Sutaj

Faleminderti shumë nga Lëvizja Vetëvendosje, Faton Selmanaj.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues përshëndetje për të gjithë, edhe ne i kemi japur komentet tona në mbledhjet e komisionit për politik e financa duke pasur parasysh pak si lokacion duket i largët atje po sido që të jetë arsyetimet kanë qenë që ka qenë kërkes edhe e Bashkësis Islame që në atë lokacion të ndërtohet ky objekt dhe si grup jemi për.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, zotri Mon Selmanaj.

Mon Selmanaj

Duke parë nevojën e Bashkisë Islame të Deqanit, unë e mbështesë pa hezitim këtë kërkesë të tyre faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Leotrim Hadergjonaj është lajmëruar për fjalë nëse ke mundësi me ndez mikrofonin.

Leotrim Hadergjonaj

Përshëndetje për të gjithë dashta një konsult me drejtorin, te kërkesa e Bashkisë Islame që është numri i parcelës dhe sipërfaqja është e ndryshme nga fleta poseduese dhe çertifikatës së pronës që është dorëzu te kërkesa e bashkisë janë 21.000 metra katror pronë komunale, ndërsa fleta poseduese është 35.000 metra katrore dhe numër tjetër ka të pronës a ka qenë mirë me ndryshu këtë para se me votu se na e kthen ministria.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë atëherë në lidhje me çështjen të cilën e ngriti përfaqësuesja e Ldk-së edhe në lidhje me qështjen që e ngriti Leotrimi ju kisha lutë drejtorit Ramë Melaj me u përgjigj.

Ramë Melaj

Të nderuar unë ju falenderoj që po pranoni që të ndahet kjo parcell për selin e Bashkësis Islame, hapësira ku mendohet te ndërtohet nuk është dikund poshtë sepse ska pas mundësi me qenë diku tjetër, por në Podin e Gështenjës u gjet kjo hapësirë.

Parcellën për të cilën ndahet kjo sipërfaqe prej 77 ari është një sipërfaqe prej 3 hektar e gjysë domethanë është një pjesë ku e ndan rruga dhe si tanësi atë pjesë e kemi ndarë ndërsa sa i përket numrave të parcellave kur është bërë laborati, gjeodeti i ka ndar këto parcella i ka qit emra të ri kështu që na me objektivin vendimin që mirret e harmonizojm tamon me kopjen e planit dhe qertifikaten e pronesis mirpo me inqizimin gjeodezik është paraqit numri i ri për atë arsye edhe kur ka shkuar kërkesa, ka shkuar sipas vendim marrjes që kanë ardhur nga gjeodetit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtor, është lajmruar për fjalë Orges Tafilaj

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesus, përshëndetje për të gjithë, unë e kisha vetëm një pyetje, prona, toka, që do të ndahet a do të kaloj si pronë e Bashkësisë Islame pastaj apo si, sa kam informacion zakonisht kur investojn kushti i parë është që toka te kalojë në pronë të tyre në mënyr që të bëhen investimet.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Ramë Melaj e ka fjalën mundësisht ndizeni mikrofonin tek vendi i tij.

Ramë Melaj

Kështu e 1-ra komunale asnjëherë nuk duhet të kalojnë në pronësi të dikujt tjetër mirpo jepet në shfrytëzim për një kohë të caktuar.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtor, a ka dikush diçka pyetje shtesë atëher me qenë se është ditë e premtë që është ditë e veçant për besimtarët islam dhe muaj i shejtë i ramazanit po e qesim në votim, po po Hyrije tash edhe po e miratojm Hyrije Dobrunaj e ka kërkuar edhe njëherë fjalën.

Hyrije Dobrunaj

Ndoshta nuk është edhe pyetje që ju duket juve me rëndësi mirëpo mua 3 hektar e gjysë po më duket që janë shumë për një objekt për atë aktivitet që ata kanë me zhvillu, ndoshta edhe nuk janë por 3 hektar e gjysë janë bukur shumë.

Ramë Melaj

Jo jo se parcella tansi ashtu, na këtë pjesë deri në 77 ari e ndajm.

Hajdar Sutaj

A ka dikush diçka shtesë, atëherë e qesë në votim kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoh që kuvendi komunal në mënyrë unanime e ka miratuar kërkesën e këshillit Bashkisë Islame në Deqan për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e objektit të Këshillit Bashkisë Islame në Deqan.

Jemi te pika e 3-të që është shqyrtimi i kërkesës së komunitetit të fshatit Llukë e Epërme për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e objektit për nevojat e komunitetit të fshatit Llukë e Epërme, në emër të grupit të Aak-së Yllarta Thaqi e ka fjalën.

Yllarta Thaqi

Faleminderit në emër të grupit të Aak-së po flas se në kërë rast njëkohësisht edhe në emër të këshillit të fshatit Llukë e Epërme, kërkesa është për ndarjen e 1 lokacioni për ndërtimin e 1 shtëpie të komunitetit të fshatit Llukë e Epërme për shfrytëzimin e nevojave të këtij komuniteti, pasi tashmë është bërë traditë si në të gjitha fshatrat e tjera dhe në fshatin Llukë e Epërme dëshiron që të ketë 1 shtëpi komuniteti ku do ta shfrytëzojnë për takime të ndryshme për këshillin lokal, për evenimente kulturore njëkohësisht dhe për ceremonitë mortore që po zhvillohen, kërkojë nga grupet e asamblistëve, subjekteve politike që ta miratojë këtë kërkesë të komunitetit të fshatit Llukë e Epërme.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, nga Ldk-ja Hyrije Dobrunaj

Hyrije Dobrunaj

Ldk-ja e mbështet këtë kërkesë të këshillit të fshatit dhe ka 1 propozim, komuna ishte dashur me u kujdesë dhe me financu këto shpija të fshatit meqenëse traditat tona nuk po na përputhen tashmë me veprimet, të gjitha traditat tona janë me majë të pame me u taku për gjithçka por nuk ka më Oda sikur kemi pasur përpara secili fshat e ka të nevojshme me pas një vendtakim, sikur ky bile Deqani gjithashtu e ka një nevojë shumë të madhe me pas, mirëpo krahas ndarjes së lokacionit, komuna duhet mbështetur me mjete financiare me u ndërtu këto shtëpi të komunitetet kudo ku mungojnë ka shumë që janë ndërtuar me vetfinancim, por tash e tutje besoj që ish dasht secili fshat me pas edhe Deqani si qytet një shtëpi të komunitetit për këtë qëllim faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Hyrije, nga Vetëvendosja Teuta Neziraj.

Teuta Neziraj

Atëherë edhe ne si grup e përkrahim kërkesën e fshatit Llukë e Epërme.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, zotri Mon Selmanaj.

Mon Selmanaj

Kërkesa shumë e nevojshme dhe unë e mbështes pa hezitim dhe këtë kërkesë të komunitetit të Llukës.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë dikush tjetër, atëherë e qes në votim kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që Kuvendi Komunal e ka miratuar kërkesën e komunitetit të fshatit Llukë e Epërme, jemi te pika e 5 që kemi të bëjmë me vendimin për shpronësimin e pronës katastrale me numër 00094-0 në zonën katastrale të fshatit Lëbushë, fillimisht ja kisha dhënë fjalën drejtorit Ramë Melaj e pastaj shefav të grupeve subjekte politike.

Ramë Melaj

Asambleist të nderuar ju e dini që jemi duke e ndërtuar rrugën nga Lëbusha deri ne Strellc pozicioni ku mendohet të shpronsohet kjo hapësirë është tek udhëkryqi ku vjen rruga e Isniqit në rrugën kryesore në fshatin Lëbush aty është edhe një rrugë ku futet në thellësi të fshatit Lëbush për me ndërtu këtë rrethrotullim është e pamundur pa u shpronsuar kjo pronë atij prapë se prapë i mbetet pak po kur të mirret kjo hapsira e nevojshme për me rregullu këtë rrethrotullim atij nuk i mbetet mundësi kurfare të hyjë në pronën e tij për këtë arsye ai ka shfaq vullnetin e tij, është në gjendje me u pajtu me shpronsu ne, ne shpronsimin do ta bëjmë sipas ligjit të shpronsimit të shtetit tonë kështu që është e nevojshme e domosdoshme të bëhet ky shpronsim kisha kërkuar që ta kalojm sepse projekti pa këtë rrethrotullim është projekt i mangët.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë.

Ramë Melaj

E keni materialin edhe e keni edhe parcelen për të cilën bëhet fjalë edhe pozicionin se ku është.

Hajdar Sutaj

Drejtor të falenderojm shumë, e kisha kaluar fjalën te shefi i grupit të Aak-së zotri Arian Dobraj në emër të grupit të Aak-ës Florim Mataj

Florim Mataj

Me qenëse u dhan dhe arsyet nga drejtori ne si grup e përkrahim është interes i projektit të rrugës kështu që vazhdojm procedurat më tutje vetëm dashta një kërkes e kisha pas që mënyra shpronimit të jetë një kosto jo e madhe që mos të jetë e pa përballushme për komunën kështu që e përkrahim si grup.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Florim, nga Ldk-ja Vatan Istrefaj.

Vatan Istrefaj

Faleminderit kryesues atëherë për këtë propozim vendim kemi diskutuar me drejtorin Ramë Melaj edhe në komitetin politik dhe financa edhe pse materiali ka ardh me vonesë për shkak të punës që ka ndodhur në atë pjesë të segmentit, ku është fjala për të mirën e përgjithshme aty nuk jemi kundër, pra jemi pro këtij propozim vendimi vetëm shpresojm që rruga të bëhet sa më shpejt faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shum Vatan, nga Vetëvendosja Faton Selmanaj.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues, në fillimisht pata një pyetje në parim jemi për me përkrah si grup po a është preteks edhe për pronat tjera domethanë për banorët e tjerë ku preken në atë zonë ku është duke u ndërtuar një rrugë që me kërku secili nga ata kompenzim.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Faton, nga Pdk-ja Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Në mbështetje kryesus të këtij propozim vendimi edhe unë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë a ka anëtar të tjerë të kuvendit konumës të cilët dëshirojn te diskutojn për këtë pikë me qenëse nuk ka të lajmëruar për fjalë, drejtori Ramë Melaj e ndezni mikrofonin ne vendin e ulsës së tij.

Ramë Melaj

Faleminderit ne kemi hasur në disa situata te cilat nuk janë kumedit qfare por i kemi tejkaluar nuk ka ndonj diqka, nuk mundem me than qe me gjet nje pretekst po kjo është një rrjedhoq qe duhet patjeter të bëhet ky shpronim sepse ati komplet prona i shkatërrohet me ndërtimin e këtij rrethi.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shum drejtor atëher e qes në votim kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që kuvendi komunal ka marr vendim për shpronësimin e pronës me numër 0094-0 zona kadastrale fshatit Lëbush, jemi te pika e 6-të e kemi propozimin e kryetarit të komunës z. Bashkim Ramosaj, për marrjen e vendimit për shpalljen qytetar nderi të gjeneralit Artur Garfield.

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës, ashtu siç e ka pasur kryetari Ramosaj, edhe takimin me përfaqësuesit e subjekteve politike dhe konsultimin me ta, po ashtu e keni të bashkangjitur një biografi të Gjeneral Brigade Artur Garfield, nëse ka dikush diçka për më thënë në lidhje me këtë pikë nga grupi i Aak-ës, fillimisht më lejoni me sa po më njofton sekretaria që nuk i keni kopjet e biografisë apo a vetëm shefat e grupeve në rregull Arian Dobraj e ka fjalën.

Arian Dobraj

Faleminderit kryesues në konsultim që kishim edhe me kryetarin Ramosaj si shefa të grupeve përfaqësuese edhe në konsultim me kolegët e mi nga grupi i Aak-ës e mbështesin kërkesën e kryetarit Ramosaj, kërkesë e cila për ne është nder dhe privilegj që me shpall qytetar nderi Gjeneralin Artur Garfield faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, ne emër të Ldk-ës shefja e grupit Hyrije Dobrunaj.

Hyrije Dobrunaj

Edhe grupi parlamentar i Ldk-ës e kemi diskutuar jemi të pajtimit të shpallet qytetar nderi gjenerali.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë grupi i Vetëvendosjes Faton Selmanaj.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesuese edhe ne si grup e mbështesim këtë ndarje.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë zotri Mon Selmanaj, faleminderit atëherë meqenëse shefat e grupeve e thanë fjalën e tyre dhe nuk ka tjerë të lajmëruar për fjalë e qes në votim kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatohet që kuvendi komunal në mënyrë unanime e ka marrë vendimin për shpalljen qytetar nderi të Gjeneral Brigade Artur Garfield, jemi te pika e 7 është propozim vendimi për një ndryshim në vendimin paraprak të cilën e ka marrë kuvendi komunal për listën rezervë me emra të rrugëve i kemi 2 pika kështu që me thanë që ministria ka kërkuar që me i bë 2 plotësim ndryshime e 1-ra emri Ali Meta është përmendur në 2 vende ka qenë gabim teknik kur ka shkruar edhe ju siq e dini një emër mundem me qen mbrenda njësis administrative të një komune vetëm një vend dhe pastaj kemi emërtimin të cilën e kemi quajtur Ura mbi Lumbardhë, ku ata thonë se mundet me u qujt vetëm Ura e Lumbardhit, sa i përket këtyre 2 ndryshimeve, të tjera gjithçka janë në rregull ju kisha lutë që ti japim miratimin e para që domethonë emri Ali Meta, që është në 2 vende të largohet të mbetet vetëm në një vend edhe Ura mbi Lumbardhë të quhet vetëm Ura e Lumbardhit kush është për?

A ka kundër?

A ka Abstenim?

Konstatohet që kuvendi komunal e ka bërë plotësim ndryshimin e vendimit për listën rezerv të emrave të rrugëve.

Jemi te pika të ndryshmet, fillimisht ishte 1 kërkesë, e cila u adresua nga kolegu z. Mon Selmanaj drejtorit të administratës që kishte të bënte me objektin komunal por edhe me parkingun e cili nuk është funksional me oborrin gjithashtu edhe me parkingun e pat fjalën që nuk është funksional, faleminderit drejtor i urbanizmit ka fjalën më falni, drejtori administratës Jashar Dobraj, oo atëherë e lus regjin që të ja kaloj fjalën Mon Selmanaj që ta elaboroj temën të cilën e ngriti faleminderit.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues përshëndetje drejtori i administratës, kohë më parë apo apo 1 vit më parë diçka ashtu e keni vendosur 1 laur në hyrje të oborrit të komunës dhe ne si kuvend por edhe të tjerat administrata sigurisht

jemi pajis me do kartela për hyrjet brenda oborrit, ajo është jashtë funksionit, dhe oborri i komunës është bërë sikur me qen në tregun e makinave në Pejë domethanë në këtë oborr tash me dal të paktën janë nja 200 makina 150 makina dhe është shëndrruar në vendparking oborri i komunës, i cili kishte me shërby për zyrtarët komunal dhe musafirë të ndryshe që frekuentojnë dhe që kanë punë në komunë prandaj pika e 1-rë e 2-ta, e 2-ta është me tualetet në komunë është një mjerim nuk e di pse nuk funksionojnë dhe nuk mirëmbahen kush është përgjegjësi a ka mjete me u rregullu këto nëse nuk ka une kisha sugjeruar që kuvendi me i nda do mjete për.. edhe për lyerjen fasadimin e koridorit këtu e keni par qysh është bërë tavani është një shej sikur me qen duke e lëshuar ne këtë objekt të komunës prandaj edhe për musafirët edhe për të tjerët edhe për ne që e frekuentojm gati për qdo ditë, është diçka e papëlqyeshme kur hyjm brenda në objekt. Une kisha kerkuar nga ju zoti drejtor që nëse nuk keni buxhet të bëni një kërkesë dhe ne të ndajm dhe të rregullohen këto çështje, për të cilat mendoj se edhe kolegët këtu që janë prezent i kanë sugjerimet dhe vërejtjet e tyre dhe i japin mbështetje kështu ju faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shum z. Mon, drejtori i administratës e ka fjalën Jashar Dobraj.

Jashar Dobraj

Faleminderit për pyetjen Mon, njëkohësisht përshëndetje për të gjithë, e vërtet kohëve të fundit nuk jemi as ne të kënaqur me menaxhimin e oborrit, që e fillove me oborrin e komunës, gjegjësisht parkingun që është parkingu i komunës po nuk i dedikohet vetëm komunës sepse janë 2 objekte komunale është edhe Pallati i Kulturës ku gravitojnë edhe shumë shoqata dhe aktivitete të ndryshme të shoqatave në fjalë që janë të sistemuara në objektin e Kulturës njëkohësisht aty operon edhe në 1 lokal afarist që e shfrytëzon parkingin ne jemi mundu disa herë që në forma të ndryshme me menaxhu oborrin e komunës përmes laurave të 2-3 formave të ndryshme, por edhe përmes kartelave që i përmende nuk kanë qenë funksionale na jemi mundu edhe brenda objektit që me funksionue ardhja e punëtorëve në punë në kohë me lajmin përmes aparatit, mirëpo edhe këtu nuk ka funksionu do të thotë u prish edhe ky aparat u prish 2-3 herë u prish laura e jemi mundu përmes drejtorisë për buxhet që me riparuar e prap është prishur vërtet duhet me provu me gjet një formë tjetër të menaxhimit, përndryshe nuk jemi as ne të kënaqur me këtë. Sa i përket te objektit brenda dhe tualteve që e përmende, na kemi kompani që e ka bërë renovimin e tyre, konsideroj që vetëm në pjesën përdhese osetë bodrumit ka pasur raste ku një pjesë e tualetit nuk ka funksionuar si duhet tjerat kanë mujt me u prish ndonjë rast, mirëpo janë të menaxhueshme të gjitha janë funksionale të gjitha janë të mirëmbajtura të gjitha unë nuk e di ku ke mundur diku tjetër me vrejt diçka që ka qenë e dëmtume. Objekti pjesa e hyrjes këtu që ka pasur vitin e kaluar e një zbrazje e ujit që e ka lëshuar pjesën e tavanit e ka derdh pjesën e lymjes së tavanit dhe ajo ende nuk është riparuar natyrisht që duhen, duhet projekt i veçantë për me bo riparimin e saj unë i kam dorëzuar edhe 2 projekte tjera në aprovim në drejtori të buxhetit dhe jan pjesë e procedurave të prokurimit për mirëmbajtje dhe të pjesës së bodrumit ku e kemi arkivin po njëkohësisht edhe pjesën që jemi pa një sallë të kunorav që besoj shpejt do të pajisemi do të furnizohemi me ndërtimin e sallës së kunorave që do të hyjë në funksion për qytetarët e komunës së Deqanit. Ka elemente të mjaftushme që nuk funksionojn ndoshta në kohë si duhet, mirëpo me shpresën që shpejt do të riparohen edhe këto që janë të dëmtuara edhe njëkohësisht të ndërdohen edhe ato që janë në munges.

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtor ishte shqetësim me vend i kolegut z.Mon Selmanaj dhe besoj që komuna dhe ju drejtoria për urbanizëm do ta keni parasysh që sa më shpejt ta rregulloni edhe laurën, por edhe detaje të tjerët të cilët kan të bëjë me funksionimin e komunës si objekt, Florim Mataj e ka fjalën a e ke në lidhje me këtë temë, a më fal vetëm prite radhën, Yllarta Thaqi e ka fjalën.

Yllarta Thaqi

Lidhur me pyetjet parlamentare për drejtorinë e kulturës apo, te departamenti i kulturës pyetjet e mia kanë qenë lidhur me bibliotekën e qytetit, zhvendosjen e bibliotekës së qytetit në qendrën rinore, është pak shqetësuese për arsye se qendra rinore edhe pse është me një kapacitet shumë të mirë, njëkohësisht është 1 ndër qendrat rinore më të mira në Kosovë është shumë larg sa i përket frekuentimit të nxënësve, sidomos të moshave më të vogla, e duhet me marrë pak shembull te komunat tjera se bibliotekat e qytetit po i vendosin

edhe afër stacioneve të autobusëve me qen më të frekuentume e jo me largu nga qytetit. Kjo ka qenë pyetja ime e lidhur me departamentin e kulturës dhe për drejtoreshën Leonora Ukaj, njëkohësisht edhe për departamentin e sportit në këtë rast jemi dëshmitarë që kemi ndarë shumë mjete sa i përket sportit në Komunën e Deqanit po ka disa vite që ne nuk shpallim sportistit të vitit, ku është arsyeja se pse nuk i shpallën sportistët e vitit, ku kemi sportistë jashtëzakonisht të mirë e komunat tjera i shpallin sportistët, sportistat e vitit, ndërsa komuna e Deqanit nuk organizon 1 event të tillë, nëse kam ndonjë përgjigje faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë gjithsesi kjo mbetet në transkript dhe në proces verbal dhe i përcillet drejtoreshës për kultur rini dhe sport

Yllarta Thaqi

Për kur, për qershor apo për korrik.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Vatan Istrefaj e ka fjalën.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesisht së pari po më vjen mirë që kryetari pas 6 muajve është këtu tek pika e të ndryshmeve, kryetar na u kan mbledhur kogja do pyetje, po po shkojm sa ma shkurt, kam një pyetje urgjente pra tek ndriçimi publik në disa fshatra, si për shembull Dubovikë tek lagjet Berisha, Strells të Epërm, Restovic, Slup është ndal ndriçimi publik qe.. te themi qe 2 a 3 ditë në Deqan, po ashtu tek shëtitorja e qytetit, tek salla e sportit disa qytetar, disa zyrtarë më kanë informuar për shkak të mospagesës Keci i ka ndalë ndriçimin publik pra e ka ndal rrymën, nëse është e vërtetë kjo si po ndihesh kryetar për shkak të të mospagesave komunës me ju ndal rryma për herë të parë ndoshta po dëgjoj po ashtu kryetar e shoh se vitin e kaluar komuna e Deqanit i ka blerë disa, ose të themi 2 motorra që do të përdoren për turizëm në komunën e Deqanit për atraksion turistik, ata motorra kan qen të blerë me vlerë dikund mbi 50.000 euro te Kaqandolli në Prishtinë qe një vitë e gjysmë nuk kam parë asnjëherë që dikush prej turistëve i ka shfrytëzuar ata motorra të themi kështu a bon me dit ku ndodhen dhe nga kush shfrytëzohen, po ashtu kryetar e pata 1 kërkesë emergjente për drejtorin e shërbimeve publike po shfrytëzoi rastin pasi që je ti këtu me të thënë ty te shkolla fillore në fshatin Strellc i Epërm kemi nevojë shumë për policë të shtrirë pasi që qarkullimi dhe lëvizja e makinave është e madhe nuk po thom në rrugën kryesore për në rrugën që hyn te sheshi i heroit Ismet Ukaj pikrishte te hyrja e shkollës, frekuentimi i madh i makinave apo veturave po rrezikon jetën e nxënësve që frekuentojnë atë rrugë për të shkuar, bukalisht për të blerë ndonjë kifile tek furra e fshatit, po ashtu kryetar është mirëmbajtja e rrugës në qendër të fshatit pikërisht përsëri te sheshi Ismet Ukaj në hyrje të fshatit është rruga pothuajse shumë e dëmtuar ju keni kontrata për mirëmbajtje të rrugëve a ka mundësi që kjo rrugë të mirëmbahet pasi që po shkakton rrezik dhe dëmtime të veturave, po ashtu pikërisht në këtë park ora apo orëmbajtje i ndriçimit publik është skajshmërisht i dëmtuar pra rrezikon direkt jetën e nxënësve dhe të ne banorëve që frekuentojm atë pjesë pasi që është i hapur faleminderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Vatan, fjalën e ka kryetari i komunës z. Bashkim Ramosaj.

Bashkim Ramosaj

Faleminderit kryesisht përshëndetje për të gjithë faleminderit dhe për pyetjet edhe për vendimet që i murrët sot ju përgëzoj për punën e mir që e keni bërë. Po shumë e vërtetë që nganjëherë nuk jemi në relacion kohor të sakt me kto kostot buxhetore me organizatat tjera buxhetore sikurse është Kedsi ne marrim buxhet 1 herë në 3 muaj dhe detyrimi jonë ndaj Kedsit është i përmuajshum për shpenzimet që i bëjmë nuk kemi pasur mirëkuptim gjatë kësaj kohe për ndriçimin publik dhe si pasoj ose si rjedhoj është ndalu ndriçimi publik deri sa të bëhet pagesa. Këto tema të tjera, shqetësime tjera, qofshin për pengesa për punë funksionale që janë obligim i komunës shërbimet publike besoj se kan njëfar rendi dhe e kan njëfar përkujdesje sistematike që

ndodh në përjashtim që kisha pasur shumë, ndoshta e kisha ndi shumë të nevojshme me nxjerr një vendim që mos me pas pengesa në rrugë më e për arsyen e vetme ne po llojm për me pas rrugë dhe mandej kërkesa e dytë është me bo kto lloj pengesash nuk e di a mundet me u rregullu kjo me e ftu ndërgjegjen e qytetarëve tanë që me pas kujdes në këto relacione apo.. policë nuk kemi të mjaftueshme që mundem ne qdo pjesë, mirpo që janë bërë të neveritshme këto pengesa janë bërë sidomos për automjetet që janë në qarkullim më të shpesht, e kemi pasur tash kohën e fundit në () me kërkesen e tyre dhe me ssitein e vedosjes të ri mirpo që kemi pasur reagime nga 4 a 5 fshatra të tjera që është pak telashe, në raportet që i kemi marrur nga policia ka qen e domosdoshme edhe vendosja e pengesave () të Epërme na u ka sygjerruar me pas edhe në () për shkak se kur bëhet një incident po krijohet një far epiqendre për qdo javë është nga një aksident që ndodh në atë pjesë. Kemi intervenuar mirpo që prap si mas bilancit që e sjellin policia prap po ka incidente këtu urojm që mos të ket ndonjë fatalitet në fëmijët tanë dhe qytetarët tanë, por po më duket që është logjik e gabueshme kjo, kam nisur me u bind që është logjik shumë e gabueshme vendosja e këtyre pengesave në rrugë e këto temat tjera ndoshta nuk i mbajta krejt pyetjet mend që jan për asetet e Kedsit në rrugen e qendrës i ka 4 vite që ka përfunduar në rast se nuk e kam gabim edhe ne jemi qe 5 vite para se me fillu punën jemi ulur në zyren me të gjithë operatorët që kanë pasur interes këtë rrugë edhe me ujësjellsin edhe me këta të fibrav optik me të gjithë duke e menduar edhe Kedsin i cili ka qenë projektus i kësaj rruge për nevojat e veta dhe u bënë 4 vite që ne nuk po mundemi me i zhvendos këto () pak e komplikuar byrokracia e tyre në këtë far raporti nuk e di nëse pati ndonjë pyetje tjetër, unë nuk arrita të mbaj ndonjë shënim tjetër, e po për motorat janë në depo nuk janë përdorur ende përfaqësisht një motor ka mundur me u përdor 2 herë për arsye të tjera mirpo që nuk kemi pasur fat dy vitet e fundit me të reshura ne borë që ndoshta me relizuar edhe atë konceptin tond që edhe i kemi blerë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kryetar Florim Mataj e ka fjalën.

Florim Mataj

Unë pata pyetje në lidhje me ndaljen e ndriqimit publik ku kisha kërkuar ndoshta nga drejtoresha e financav me na dhënë një përgjigje kur do të paguhet dhe kur do të jet funksional se ne e morrëm edhe një përgjigje nga kryetari por të paktën të e dim a do të ndodh pas 3 muajve apo mbrenda 2 a 3 dite le të jet pagesa që te lëshohet ndriqimi kaq kisha.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, drejtoresha për buxhet dhe financa e ka fjalën.

Dafina Cacaj

Po faleminderit Florim, jo në 3 muaj por un po besoj javën vetëm lshohet për shkak se buxheti tash në fillim të muajit është ne i kemi pasur mjetet për rrymë mirpo na i kan marrë me përmbaram edhe momentin që unë kom bisedu me Kedsin ata kanë pas mirëkuptimin që me na prit qdo muaj i paguajm aq sa i kemi për me zënë hapin edhe nuk kanë pasë mirëkuptim se do ora veç janë të monitoruara prej qendrës dhe ndalen direkt, janë ndal disa prej tyre jo krejt se borxhi është i përbashkët për të gjitha ato që kanë pasur borxhin pak më të madh i kan ndal po besoj që javën tjetër veq rregullohet gjethqka.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Albesa Cacaj e ka kërkuar fjalën.

Albesa Cacaj

Atëher kam një sqarim ose 2 pyetje për kryesusin, kryesus nga muaji janar kur jam deklaruar edhe tu kam drejtuar që ti bën shkelje je munduar të më vendosësh fajin mua duke më thënë që unë kam përpara një rregullore e cila saktëson që shprehimisht kohëzgjatja e një deklarimi të një asambleisti është 3 minuta dotëthotë kryesusi i kuvendit nënshkruan të gjitha aktet e miratuara nga kuvendi, pra ne rregulloren e punës, e cila është miratuar në vitin 2022, është nënshkrimi juaj pra i kësaj rregullore ku thuhet se 1 asamblist ka te drejt, te diskutoj për çështje në kohëzgjatje prej 5 minutash, ndërsa shefi i grupit në kohëzgjatje prej 7

minutash, domethanë 2 - 3 seanca ti ma ke ndalu fjalën me arsyetimin qe ke te drejtë me diskutu vetëm 3 minuta, kjo ishte qështja e 1-rë sa për qartësi dhe saktësi të opinionit. Çështja e 2-të që vazhdimisht e kam ngrit në komitetin në të cilin jam pjesë përbërëse ose komitetet që krijohen është mungesa e procesverbalit ose procesmbajtësit, konkretisht ne komitetin për komunitete deri vonë punën e procesmbajtësit e ka kry zyrtari për integritet evropiane, gjë që nuk i ka takuar, me insistimin tim është ardh zyrtari tjetër por muajin janar dhe mars ka mungu dhe shprehimisht edhe te udhëzimi administrativ për themelimin e komiteteve të përhershme thuhet se duhet të jetë i pranishëm procesmbajtësit që procesverbalin ta miratojmë ta lexojmë në mbledhjen e ardhshme dhe kjo është sugjerim, kërkesë që është tepër e nevojshme tjetra është pyetja që kam delegu në mbledhjen e kalume sa i përket raportit të veprimeve që ka ndërmarrë komuna lidhur me veprimet për shqyrtimin e rekomandimeve nga auditori i jashtëm, pra nëse më lejohet raporti i auditimit të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2023 ka rezultuar me 12 rekomandime, prej të cilave 3 janë të reja dhe 9 të përsëritura, komuna ka pasur obligim që të paraqesë 1 plan të veprimit, ku paraqitet mënyra se si ti zbatojë rekomandimet e dhëna mirëpo komuna nuk ka raportu me kohë lidhur me zbatimin e rekomandimeve përmes raporteve periodike të zbatimit të rekomandimeve, të cilat do duhej të dorëzoheshin me 30.09.2024 dhe me 15.03.2025, kështu që kam kërku në mbledhjen e kalume nuk ka qenë i pranishëm as kryetari që këtë mbledhje të diskutohet lidhur me procesin.

Hajdar Sutaj

A keni mundësi me vazhdu fjalën.

Albesa Cacaj

Pyetja tjetër do doja të ja drejtoja z. Ramë Melaj me 10.10.2022 drejtori është deklaruar që janë në proces të hartimit hartat zonale kisha dasht me marr edhe këtu 1 përgjigje, pastaj kam shumë pyetje edhe për drejtorin për shërbime publike po meqë nuk është i pranishëm po mendoj se nuk është e arsyeshme as me i deklaruar faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Albesa, sa i përket procesmbajtësit ju e dini që nuk kemi staf si kuvend komunal dhe për shkak se, nuk e di para 4 viteve që vetëm ishte miratuar një udhëzim administrativ që ja mundëson domethanë kuvendev me i pasë 5 zyrtar po me ndërrimin e qeveris, qeveria ka terhequr atë udhëzim administrativ edhe asociacioni i komunave është në përpjekje të vazhdueshme që më kriju këtë mundësi që kuvendet komunale me pas edhe stafin e tyre, përbërje prej zyrtarëve ligjorë ekonomistë, procesëmbajts, gjygtar e të tjerë, por jemi në këto rrethana që jemi, sa i përket auditorit nuk e di kush ka me dhënë përgjigje tash, sa i përket rregullores, na veç e kemi pasur një.. kur është montuar domethonë kjo aparatura që të jetë 3 minuta, por megjithatë e bëjmë këtë plotësim, kemi qen edhe ne presion me shkurtu edhe kohën, e sa i përket auditorit, a pat dikush diçka me thënë, nuk patëm diçka në lidhje me ata, e ka kërkuar fjalën Orges Tafilaj, nuk ta përmenda emrin, Orgesi e ka fjalën.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesus, kryetar erërat e forta e kanë larguar pasqyrën orientuese të komunikacionit te këndi i vdekur rrugës për tek shkolla e fshatit Lëbush meqenëse edhe prindërit e fëmijëve edhe mësimdhënësit, shumica e tyre i sjellin fëmijët me makina në shkollë është shumë mirë që të sanohet ky problem përderisa po rrezikohet jeta e atyre fëmijëve, edhe njerëzve të tjerë që frekuentojnë atë rrugë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges, drejtori Ramë Melaj e ka fjalën.

Ramë Melaj

Faleminderit për pyetjen ju siç e dini keni votu planin zhvillimor komunal e keni aprovuar edhe nga ministria e administrimit pushtetit lokal e kemi marrë aprovimin ligjor që jemi në harmoni me ligjin dhe tash dokumenti është pothuajse funksional, sa i përket hatës sezonale ne jemi në proces, jemi duke punuar në hartën zonale

jemi në kompletimin e dokumentacionit besoj se së shpejti do të kemi 1 draft, mirëpo punë është duke na marrur sepse ka shumë angazhim, mendoj që për 3 a 4 muaj edhe ky dokument do të përmbillet si dokument dhe do të jemi me një dokument shumë të rëndësishëm për komunën.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë të tjerë nuk ka të lajmëruar për fjalë edhe.. po pse nuk ja kam përmendur emrin tash kjo është duke thënë mos me shkel rregulloren, unë i kërkoj falje nëse e kam shkelur rregulloren po tash nuk po e shkeli Atëher urime përfundimi i këtij muaj të shenjtë Ramazanit, urime Festa e Bajramit me kaq e mbylli këtë takim mirë u takofshim në mbledhjen e ardhëshme.

